



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr. 109/2Prot.

Tiranë, më 30.12.2013

MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA



PROGRAMET E ARSIMIT BAZË

(Për klasat e shansit të dytë)

LËNDA: EDUKIM FIGURATIV

KLASA VI-IX

Tiranë

Dhjetor 2013

Edukimi figurativ është një pjesë e rëndësishme e përgatitjes së ardhshme të nxënësit, luan rol të rëndësishëm në shprehjen e emocioneve, të jetës shpirtërore, kulturore, shoqërore dhe zhvillimit intelektual të njeriut. Si i tillë ai ka marrë sot vendin e merituar në programin mësimor të arsimit të detyruar. Edukimi figurativ vlerësohet si një nga mënyrat më të frytshme për edukimin estetik dhe zhvillimin mendor të fëmijës, për vetë faktin e ndërtimit specifik të trurit të njeriut dhe aq më tepër të karakteristikave mendore të fëmijëve, si dhe të lidhjeve të ngushta që ka me të shkruarit e lëndë të tjera në shkollë.

Programi i edukimit figurativ në sistemin e ri arsimor të shkollës sonë, sjell në përmbajtjen e tij përvojën më të mirë të një programi arti të studiuar nga ana psikologjike dhe artistike në përputhje me moshën. Programi realizon atë që duhet të njohin dhe të bëjnë nxënësit në edukimin figurativ. Ai ka në qendër përvojën e nxënësit, të cilën kërkon ta njohë, ta zhvillojë, ta pasurojë e ta çojë më përpara, duke e ndërthurur atë në mënyrë të natyrshme me historinë, kulturën, artin jo vetëm të mjedisit ku jeton e mëson fëmija, por me atë të krahinave të tjera të atdheut të tij e të vendeve të ndryshme të botës, që ai ta ndjejë veten pjesë të së tërës, të botës ku jeton.

Të përgatitësh fëmijët për të ardhmen, duhet që t'i edukosh ata në mënyrë të tillë që jo vetëm të kuptojnë botën që na rrethon, por të japin edhe ndihmesën e tyre. Ata duhet të dinë të bëjnë më shumë, të dinë si të përvetësojnë çdo ndryshim të teknologjisë dhe të shkëmbimit të informacionit. Sot në botë ka më shumë informacion se mund të shprehin fjalët dhe numrat, e kjo gjen pasqyrim në edukimin figurativ e programin që u paraqesim për të punuar me nxënësit. Ky program e ndihmon nxënësin të zhvillojë aftësitë e tij për të qenë sa më i suksesshëm në jetë.

SYNIMI I LËNDËS

Programi i edukimit figurativ ka për qëllim t'i aftësojë nxënësit për të krijuar përmes artit figurativ dhe shprehur nëpërmjet tij.

Objektivat

Mësimi i edukimit figurativ ka për qëllim që nxënësit në fund të klasës së tetë:

- të prodhojnë punë me dy dhe tri përmasa që komunikojnë ide (mendime, ndjenja, përvoja) për qëllime të caktuara dhe për një nivel të caktuar, duke përdorur lloje të ndryshme mjetesh, materialesh dhe teknikash;
- të identifikojnë elementet e artit (ngjyrën, hijen, formën, hapësirën, sipërfaqen) dhe parimet e artit (theksin, balancën, ritmin, unitetin, përpjesëtimet) dhe t'i përdorë ato në mënyrë të përshtatshme për këtë nivel kur prodhon një punë arti;
- të shpjegojnë dhe të interpretojnë disa vepra arti, duke treguar si elementet dhe parimet e artit janë përdorur në to;
- të përdorin fjalorin dhe terminologjinë e duhur në përshtatje me këtë nivel.

LINJAT E PROGRAMIT

Programi i Edukimit figurativ, për klasat e Shansit të Dytë, arsimit të mesëm të ulët është i organizuar në bazë të 6 linjave të cilat zërthehen si më poshtë:

1. Baza materiale, procese, teknika
2. Parime dhe elemente
3. Tematika
4. Historia dhe kultura
5. Analiza, interpretimi, vlerësimi
6. Lidhjet ndërëndore me jetën

METODOLOGJIA

Në qendër të metodologjisë së lëndës së edukimit figurativ është përvoja dhe aftësia e nxënësit, të cilat i formon, i përmirëson dhe i edukon vazhdimisht gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij. Duhet pasur parasysh që në këtë klasë nxënësi vjen me një përvojë dhe aftësi të formuar për moshën nga programi i edukimit figurativ të arsimit fillor (klasat I – V). Mësuesi duhet të përdorë forma të larmishme, si:

- vëzhgimi,
- ilustrimi,
- zëbrthimi i saktë i temës dhe njohurive,
- nxitja e veprimtaria e drejtuar,
- veprimtaria e pavarur,
- zgjerimi i njohurive për konceptin e marrë,

- vlerësimi artistik etj.

Karakteristikë e rëndësishme, si në të gjithë programin, është liria vetjake në krijim, e cila do të thotë që nxënësi të zbatojë njohuritë e marra nga programi duke ua përshtatur stilit të tij të punës dhe ëndërrimeve të tij.

Është shumë e rëndësishme që bashkëpunimin mësues–nxënës gjatë procesit mësimor të mbështetet edhe në përvojën vetjake të nxënësve.

Mjetet dhe përdorimi i tyre

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi të çdo nxënësi me mjete vetjake, mund të përdoren mjetet në grup.

Mjetet më të rëndësishme janë:

Grupi i parë: shkumësa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe laps i zi HB, lapustila, akuarelet, pastelet.

Grupi i dytë: vinovil, letër ngjitëse, skoç, vizore, gërshërë.

Grupi i tretë: penela të ndryshëm (të disa madhësive, të cilët janë të përcaktuar në paketa të veçanta), fletore vizatimi, fletore për punëdore, letër tabak, kartonë me ngjyra, letër për të shkruar A4.

Grupi i katërt: aparat fotografik (një për të gjithë klasën), kompjuter (sipas mundësive).

Grupi i pestë: mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempera, akuarel.

Grupi i gjashtë: mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, kartëpeceta, gazeta.

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e edukimit figurative, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë më një dritë të plotë, me një vend të sigurt, ku mund të mbështesë mjetet e punës, në një vend të ngrohtë, pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurative është klasa-studio. Në pamundësi të saj, klasa të ketë kushtet e përshtatshme.

UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve edhe në këtë nivel do të bëhet në bazë të arritjeve që realizon në veprimtarinë praktike e krijuese, pra sa ai arrin të realizojë në praktikë nga njohuritë e marra. Një mënyrë tjetër vlerësimi është edhe aftësia analizuese e vlerësuese që nxënësi i bën punës së tij, të shokut apo edhe të një vepre arti. Ky lloj vlerësimi mund të jetë edhe orë më vete kur kemi analizë të veprave të artit, por mund të jetë edhe në fund të një teme të caktuar, kur në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit. Vlerësimi mund të bëhet ose jo pas çdo teme mësimore ku mësuesi shfaq mendimin e tij për çdo krijim të nxënësit.

Vlerësimi nuk do të bazohet në konkurrencë, por në bazë të një diskutimi të natyrshëm për arritjet dhe ato që nxënësit duhet të realizojnë më mirë në veprimtarinë praktike e krijuese. Në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit dhe zakonisht bëhet në fund të orës së mësimi. Vlerësimi nuk do të thotë që të bëhet çdo orë, por e rëndësishme është që mësuesit të reagojnë gjithmonë gjatë veprimtarisë së nxënësit. Vlerësimi bëhet për grup-temash për të gjithë nxënësit, apo dhe në mënyrë individuale sipas kriterëve që mund të vendosë shkolla.

Vlerësimi është një moment i rëndësishëm në të cilin ka patur debate për të arritur saktësi. Standardet e arritjes i orientojnë mësuesit si të mbështeten në krijimet dhe interpretimet e nxënësve për të përcaktuar saktë vlerësimin e tyre. Mënyrat për të arritur në saktësi, janë të shumta .

Mësuesi zgjedh mënyrën për të vlerësuar, si: vëzhgimin, pjesëmarrjen, interpretimin, shkallën e vështirësisë, kontrollin e dosjes së punimeve, vlerësimin e ekspozitave, vetëvlerësimin, origjinalitetin në krijim, përshkallëzimin në punë etj.

Vlerësimi mbështetet mbi parime, si:

- të vlerësojë krijimtarinë e nxënësit, jo imitimin e punës së shokut apo të figurave që paraqiten për ilustrim.
- të nxisë krijimin e dosjes së punimeve që është një dokumentacion, i cili krijon një sistemim të njohurive, prandaj mësuesi duhet ta kërkojë dhe në një kohë të përshtatshme e merr si dokument vlerësimi.
- të përdorin fjalorin artistik si një testim i njohurive artistike.

- të vlerësohet diskutimi, dhënia e ideve, lidhja e veprimtarisë jetësore me artin, p.sh., veshja e bukur, dekorimet në to e në mjediset e shkollës, ku secili nxënës shpreh shkallën e formimit të tij.

INTEGRIMI

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit do të kapin me lehtësi lidhjet e kësaj fushe arti me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore dhe me mjedisin. Kjo lëndë tregon se sa i lidhur është edukimi figurativ me jetën tonë të përditshme, duke u siguruar mundësinë nxënësve që të krijojnë punë të ndryshme, duke ndërthurur artin pamor me forma të tjera të artit. Kështu, për shembull, nxënësi mund të krijojë mbasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike me një etapë të zhvillimit të edukimit figurativ, të kuptojë krijimin e ngjyrave përmes përbërësve kimikë. Mund të krijojë në kompjuter, duke përdorur elementet e edukimit figurativ dhe median elektronike etj.

MJETET DHE PËRDORIMI I TYRE

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës. Në pamundësi, shkolla mund të përdorë mjetet në grup.

Mjetet më të rëndësishme janë :

Grupi i parë: shkumsa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe lapsi zi HB, lapustila, akuarelet, pastela.

Grupi i dytë: vinovil, letërngjitëse, skoç, vizore, gërshtë.

Grupi i tretë: penela të ndryshme, të cilat janë të përcaktuara në paketa të veçanta (të jenë të disa madhësive), fletore vizatimi, fletore për punëdore, letër tabak, kartona me ngjyra, letër për të shkruar A4.

Grupi i katërt: mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempera, akuarel.

Grupi i pestë: mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, peceta, gazeta (për mësuesin duhet të krijohet një bazë e fuqishme për ilustrim).

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e artit pamor, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë me një dritë të plotë, në një vend të sigurt, ku t'i mbështesë mjetet e tij, në një vend të ngrohët e pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurativ është klasa si studio (kabineti i posaçëm i artit figurative). Në pamundësi, duhet që klasa të ketë kushtet e përshtatëshme.

KLASA VI

30 javë x 1 orë = 30 orë

1. Baza materiale, procese e teknika	3 orë
2. Elemente dhe parime	13 orë
3. Tematika	4 orë
4. Histori dhe kulturë	3 orë
5. Analiza, interpretimi , vlerësimi	3 orë
6. Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin	4 orë

PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

LINJA I. Baza materiale, proceset, teknikat

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të aftësohet në përdorimin e bazës materiale, të teknikave dhe proceseve që do të përdoren në këtë klasë, si: lapsi, letra, goma, ngjitësi, akuareli, vizatimi, tempera, kolazhi, instalacioni, pastelina, stampimi, skulptura, fotografia, kompjuteri etj.
- Të përzgjedhë bazën materiale dhe teknikën e përshtatshme për të ilustruar njohuritë e marra tek elementet dhe parimet, p.sh.:
 - të përdorë lapsin dhe teknikën e vizatimit për të modeluar formën;
 - të përdorë temperat për të krijuar vlerat e ngjyrave;
 - të përdorë kolazhin për të ilustruar njohuritë për sipërfaqen;
 - të përdorë plastelinën për të krijuar vëllimin etj.
- Të përdorë bazën materiale, teknikën dhe proceset për të komunikuar ndjenja e emocione.

LINJA II. Elemente dhe parime

13 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Vijat:
 - të gjejë vijat në një punë artistike duke shpjeguar si ndikojnë karakteristikat specifike të vijës në gjendjen e kompozimit – (*bisedë e ilustruar me vepra arti psh. "Krijimi" nga Mikelanxhelo, skica me rapid për të krijuar emocione të ndryshme*);
- Format dypërmasore:
 - të njohë format e sakta (2-përmasore) gjeometrike dhe format manuale (të krijuara nga dora), përdorimin e tyre në kompozim - (*bisedë, vëzhgim krijim*);
- Format trepërmasore:
 - të vëzhgojë format gjeometrike (3-përmasore) dhe organike, duke kuptuar lidhjen e ngushtë të formës dhe të vëllimit - (*krijim me plastelinë*);
- Vlera:
 - të njohë dritëhijen si vlerë – (*natyrë e qetë: sfera dhe kubi*);
- Sipërfaqja:
 - të njohë që të gjitha objektet në natyrë kanë një cilësi të sipërfaqes dhe të materialit – (*bisedë dhe krijim në teknikën e pastelit ose të kolazhit*);
- Ngjyra:
 - të njohë tri emërtimet e ngjyrave:
 - emërtimi i ngjyrave
 - vlerat: të çelëta / të erëta
 - intesiteti: të ndriçuara/të turbullta - (*bisedë e ilustruar me punë krijuese*);
- Hapësira:
 - të njohë e të analizojë efektin e bashkimit të qiellit, të tokës dhe të objekteve që ndodhen në të, në një vepër arti – (*rruga me pemë në perspektivë*);
- Barazpesha:

- të njohë barazpeshën në një vepër arti dhe ta përdorë atë në krijimet e tij – *(fotografi artistike)*;
- Theksi dhe lëvizja:
 - të njohë e të përdorë efektet që krijojnë theksin, p. sh., kontrasti, si dhe lëvizjen nëpërmjet vendosjes së elementeve – *(krijo theksin duke vënë në qendër figurën kryesore)*;
- Uniteti:
 - të njohë unitetin si parim i artit – *(krijim varsja, byzylyku për ditën e nënës)*;
- Kontrasti:
 - të vëzhgojë dhe të gjejë kontrastin në mjedisin rrethues – *(bisedë)*;
- Harmonia:
 - të kuptojë që përsëritja e elementeve, si: forma, vija, ngjyra, krijojnë harmoninë në kompozim - *(krijim formal me motive floreale, në mozaik, stampim, etj)*.

LINJA III. Tematika

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të përzgjedhë bazën materiale dhe teknikën në shërbim të temës;
- të komunikojë ndjenja e mendime nëpërmjet temave të larmishme – *(krijim, punë në grup ku nxënësit zgjedhin një temë të caktuar)*.

LINJA IV. Historia dhe kultura

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të njohë artistë shqiptarë në periudha të ndryshme, si dhe veprat e tyre - *(bisedë - artistë të periudhës së Rilindjes si Kolë Idromeno, Simon Rrota)*;
- të njohë arkitekturën e spikatur shqiptare (Berat, Gjirokastrë etj.);
- të dallojë artistë të periudhave të ndryshme të historisë së artit dhe veprimtarinë e tyre artistike *(përfaqësues të Rilindjes italiane dhe të impresionizmit si ,Leonardo da Vinçi, Mikelanxhelo, Rafaelo, Mone, Sezan)*.

LINJA V. Analiza, interpretimi, vlerësimi

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të analizojë dhe të vlerësojë preferencat artistike të tij dhe të shokut;
- të analizojë elementet dhe parimet, teknikën, idenë dhe mesazhin që ajo përcjell në një vepër arti, duke përdorur fjalorin e duhur artistik;
- të bëjë dallimin ndërmjet një vepre arti origjinale dhe një vepre të riprodhuar.

LINJA VI. Lidhja ndërlëndore dhe me mjedisin 4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- të njohë dhe të vlerësojë se çfarë e bën një objekt vepër arti: -(*bisedë*);
- të njohë traditat, zakonet dhe vlerat artistike popullore: - *shikon filma dokumentarë, albume, libra artistikë etj.*;
- të njohë dhe të bëjë lidhjen e edukimit figurativ me lloje të tjera të artit, si me letërsinë për ilustrimin e një pjese letrare – (*muzikën, shkencat, etj*).

KLASA VII

30 javë x 1 orë = 30 orë

1. Baza materiale, procese e teknika	3 orë
2. Elemente dhe parime	14 orë
3. Tematika	4 orë
4. Histori dhe kulturë	3 orë
5. Analiza, interpretimi , vlerësimi	3 orë
6. Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin	3 orë

PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

LINJA I. Baza materiale, proceset, teknikat 3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të aftësohet në përdorimin e bazës materiale, të teknikave dhe proceseve që do të përdorë në këtë klasë, si: lapsi, goma, letra, ngjitësi, akuareli, vizatimi, tempera, kolazhi, instalacioni, plastelina, stampimi, skulptura, fotografia, kompjuteri etj.
- Të përzgjedhë mjetin e duhur për të ilustruar njohuritë e marra tek linja “Elemente dhe parime”.
- Të përzgjedhë mjetin e duhur për të ilustruar llojet e ndryshme të linjave (p.sh., lapsin, stilolapsin, penën, rapidin, lapustilën, karbonin, penelin etj.).
- Të përdorë teknikën e vizatimit për t’u dhënë objekteve volum dhe peshë.
- Të përdorë temperat për të krijuar vlerat e ngjyrave.
- Të përdorë teknikën e përshtatshme për të ilustruar sipërfaqen (p.sh., kolazhin ose pastelet).
- Të përdorë penën ose rapidin si mjet për teknikat e grafikës për të ilustruar kontrastin.

LINJA II. Elemente dhe parime

14 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

Vijat

- Të njohë dhe të përdorë në krijimet e tij karakteristikat e vijës (e dhëmbëzuar, zigzage, e pikëzuar, e harkuar, horizontale, vertikale, diagonale).
- Kompozimin me të cilin përdoren karakteristika linjash të ndryshme për të krijuar një gjendje të caktuar.

Format dypërmasore

- Të dallojë format organike që gjenden në natyrë (ato janë forma të lira dhe jo të rregullta). Kolazh me objekte të gjetura në natyrë, si: gjethe, fije, shkopinj etj.

Format trepërmasore

- Të njohë, të kuptojë dhe të dallojë që forma ka volum dhe peshë (vizatim objekti nga natyra ose krijim në plastelinë).

Vlera

- Të krijojë rrethin e madh të ngjyrave nëpërmjet të bardhës për të ndriçuar ato dhe nëpërmjet të zezës për të errësuar (ushtrime praktikë për të kuptuar vlerat e ngjyrave, me tempera ose akuarel).

Sipërfaqja

- Të njohë sipërfaqen si një element të rëndësishëm të artit, duke e kuptuar atë në dy mënyra: nëpërmjet të prekurit dhe të parit.

(Bisedë në klasë e ilustruar me objekte me cilësi të ndryshme sipërfaqeje dhe me fotografi veprash arti, ku cilësitë e sipërfaqeve të objekteve të pikturuara dallohen nëpërmjet të parit).

Ngjyra

- Të krijojë rrethin e madh të ngjyrave (ngjyrat parësore, dytësore dhe të ndërmjetme).

Barazpesha

- Të përdorë barazpeshën formale në krijimin e tij (krijim i një dekoracioni simetrik me motive popullore).

Theksi

- Të krijojë theksin në kompozim duke përdorur kontrastin (ilustrimi i një pjese letrare ku nxënësi nëpërmjet kontrastit që krijon në kompozim, thekson objektin ose personazhin më të rëndësishëm).

Lëvizja

- Të kuptojë që lëvizja na ndihmon të vëzhgojmë një vepër arti (bisedë e ilustruar me vepra arti në klasë ose në një galeri artesh).

Uniteti

- Të krijojë duke përdorur e njësuar (shkuar) elementet e parimet e artit (krijimi i lirë ku nxënësi të përdorë njohuritë e marra për ngjyrën, linjën, formën etj., në shërbim të kompozimit të tij në mënyrë sa më harmonike).

Kontrasti

- Të krijojë kontrastin në një krijim duke përdorur lloje të ndryshme linjash, formash, ngjyrash etj. (psh, krijim “Nata dhe dita”, përdorimi i ngjyrave të errëta dhe të çelëta për të krijuar kontrastin etj).

Harmonia

- Të krijojë harmoni në një krijim duke përdorur ritmin (përsëritjen e organizuar të një ose më shumë elementeve të artit). (Stampim me patate ose çfarëdo ku ritmi krijohet nëpërmjet përsëritjes së formave e ngjyrave).

LINJA III. Tematika

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të përzgjedhë elementet e parimet e artit në shërbim të temës.
- Të përzgjedhë bazën materiale e teknikën në shërbim të përmbajtjes.
- Të komunikojë ndjenja mendime nëpërmjet temave të larmishme.

Krijim punë në grup.

LINJA IV. Historia dhe kultura

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë dhe të krahasojë vepra arti të periudhave të ndryshme historike (p.sh., të dallojë artin bizantin nga Rilindja Italiane, impresionizmin, realizmin etj.)
- Të njohë artin mesjetar shqiptar dhe artistët më të njohur të kësaj periudhe, Onufri, David Selenica, vëllëzërit Shpataraku etj.
- Të njohë arkitekturën në lidhje me historinë (ndërtesat më të njohura e më të spikatura, p.sh., Koloseun ne Romë, Harkun e Trumfit në Paris, Kishën e Shën Pjeterit, Kullën Eifel, piramidat etj.)

LINJA V. Analiza, interpretimi dhe vlerësimi

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë dhe të kuptojë dritën si një faktor shumë i rëndësishëm natyror, e cila bën të mundur perceptimin tonë për elementet e artit: ngjyra, sipërfaqja, forma etj. (kjo orë mund të zhvillohet në formën e një bisede, ku nxënësit vënë në përdorim njohuritë e marra në fizikë, ose mund të jetë një bashkëpunim i mësuesit të fizikës dhe të edukimit figurativ).
- Të analizojë e të vlerësojë punën e tij dhe të shokut.
- Të analizojë elementet e parimet e artit të mësuara në këtë nivel në vepra arti (bisedë për vepra të ndryshme arti, ilustrime të gjetura nga mësuesi dhe nga vetë nxënësit).

LINJAVI. Lidhja ndërlëndore dhe me mjedisin

3 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të kuptojë se çfarë e bën një objekt vepër arti.
- Të identifikojë marrëdhëniet e artit më jetën e përditshme (instalacion me objekte të ndryshme)
- Të krijojë, të stilojë një veshje moderne duke u mbështetur në traditën popullore të veshjes.

KLASA VIII

30 javë x 1 orë = 30 orë

1. Baza materiale, procese e teknika	2 orë
2. Elemente dhe parime	14 orë
3. Tematika	4 orë
4. Histori dhe kulturë	4 orë
5. Analiza, interpretimi , vlerësimi	3 orë
6. Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin	3 orë

PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Objektivat e programit zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

LINJA I. Baza materiale, proceset, teknikat **2 orë**

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të aftësohet në përdorimin e *bazës materiale*, si: lapsi, goma, letra, ngjitësi, gërshëra, plastelina, bojërat, aparati fotografik, kompjuteri etj.; *teknikave dhe proceseve*, si: akuareli, temper, pasteli, vizatimi, kolazhi, skulptura, instilacioni, stampimi, fotografia, kompjuteri, duke përzgjedhur mjetin e duhur për të ilustruar njohuritë e marra në të gjitha linjat e tjera të programit.
- Të përdorë bazën materiale, teknikën e proceset për të kumtuar ndjenja, mendime dhe emocione. *Bisedë dhe krijim* (duke përdorur mjete dhe materiale të ndryshme sipas dëshirës.)

LINJA II. Elemente dhe parime

14 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë dhe të përdorë përsëritjen e linjës për të krijuar sipërfaqe dhe për të modeluar. (*Vijat – p.sh : Natyrë e qetë, e realizuar në teknikën e vizatimit me dritë-hije*).
- Të njohë përdorimin e linjës si drejtuese të syve të shikuesit përgjatë kompozimit *Bisedë- (për shembull, për veprën “Krijimi” i Leonardo da Vinçit)*.
- Të njohë dhe të krijojë objekte nëpërmjet bashkëndimit të formave organike dhe gjeometrike. (*Format 2 përmasore p.sh: Krijim - vizatimi i objekteve të përdorimit të përditshëm ku ndërthuren format gjeometrike dhe organike*).
- Të kuptojë që hija shfaqet si e kundërta e burimit të dritës. (*Format 3 përmasore p.sh – Fotografi nga momente të ndryshme të ditës dhe shpjegimi i efekteve të dritës dhe kontrastit*).
- Të kuptojë që dritë-hija bëhet e dukshme nëpërmjet burimit të dritës (*Vlerat – p.sh: Krijim - Në diskotekë*).
- Të krijojë sipërfaqen nëpërmjet përsëritjes së vijave, hijeve dhe hapësirës (*Sipërfaqja – p.sh: Endje me materiale të ndryshme, si: fije, letra, kashtë etj*).
- Të krijojë duke përdorur ngjyrat e ngrohta dhe te ftohta (*Ngjyra- p.sh: Krijim, kompozim me ngjyra të ngrohta dhe ngjyra të ftohta*).
- Të kuptojë që objektet paraqiten të mëdha kur ato janë afër nesh dhe të vogla kur janë larg. (*Hapësira p.sh: Përdorimi i këtij koncepti tek filmat vizatimorë dhe krijimi i një situate të tillë*).
- Të njohë, të kuptojë baraspeshën informale (*Baraspesha p.sh: Kompozim i ndarë në dy pjesë (për shembull: “Vera dhe dimri” ose “E mira dhe e keqja” etj.*).
- Të kuptojë që nëse sytë e shikuesit lëvizin përgjatë kompozimit, në përgjithësi, shikimi fillon dhe mbaron në zonën e theksi (*Theksi p.sh: Peizazh ose krijim i lirë*).
- Të njohë dhe të kuptojë lëvizjen, nëpërmjet krijimit të formave organike dhe linjave të harkuara. (*Lëvizja p.sh: Ilustrimi i një poezie të Lasgush Poradecit*)

- Të kuptojë që unifikimi i elementeve të ndryshme kryhet nëpërmjet mbivendosjes, lidhjes, përsëritjes etj. (*Uniteti – p.sh: Bisedë: njohja me veprat e kubistëve dhe krijim duke u mbështetur në veprat e tyre, si: Pikaso, Brak etj.*)
- Të krijojë duke përdorur kontrastin dhe variacionin për të krijuar qendrën e interesit për të tërhequr vëmendjen e shikuesit (*Kontrasti p.sh: Krijim i lirë*).
- Të krijojë harmoninë nëpërmjet kombinimit të formave dhe linjave (*Harmonia – p.sh: Skulpturë me baltë ose me plastelinë ose instilacion me objekte të riciklueshme*)

LINJA III. Tematika

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë dhe të përdorë simbolin për pasurimin e tematikës. Njohja me simbolet p.sh: *Krijim*.

LINJA IV. Historia dhe kultura

4 orë

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë artin dhe artistë të realizmit socialist (shembuj nga vepra të ndryshme të kësaj periudhe)
- Të njohë arkitekturën e kësaj periudhe (shembuj të ndryshëm nga arkitektura).
- Të njohë dhe të vlerësojë vepra të artit në periudha të ndryshme të historisë së artit (*impresionizmi, ekspresionizmi, simbolizmi etj.*).

LINJA V. Analiza , interpretimi dhe vlerësimi

3 orë

- Të njohë dhe të analizojë fotografinë artistike. Të analizojë dhe të mbajë qëndrim ndaj punës së tij, të shokut dhe veprave të artit p.sh: *Bisedë për fotografë të njohur shqiptarë, si: Marubi, Reli etj.*

LINJA VI. Lidhja ndërlëndore, me jetën dhe me mjedisin**3 orë**

Në këtë linjë nxënësi duhet të jenë në gjendje:

- Të njohë simbolet në kultura e kohë të ndryshme (ky objektivi lidhet me objektivin e linjës së tematikës dhe mund të realizohet në një orë të përbashkët) p.sh: *Krijim - logo të ndryshme.*
- Të krijojë punë arti në lidhje me lëndë të ndryshme (të krijojë punë në kompjuter me programe të thjeshta, skenën dhe kukullat për një teatër kukullash, të ideojë këndin e matematikës, të letërsisë apo biologjisë etj. në shkollë).